



Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Anton Shala, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Xhevat Tafa, U. D i Drejtorit të Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 11/06 /2019 Nr. 020-662
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Rregullore	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullore nr.011/01-21955 e punës së Kuvendit të Komunës së Gjakovës
I miratuar më datë: 03.06.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë:07.06.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të komunës së lart cekur, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za:	Ardian Gjini, gradonačelnik Opštine Đakovica Anton Shala, predsedavajući Skupštine opštine Đakovica	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Xhevat Tafa v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MALS	Datum, 11.06.2019.
Predmet:	Potvrda zakonitosti akata opštine Đakovica	Br.020-662
Vrsta akta:	<input type="checkbox"/> Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-05 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Pravilnik br.011/01-21955 o radu Skupštine opštine Đakovica
Usvojena dana, 03.06.2019. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 07.06.2019. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je **opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat.**

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA - MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosovo
 Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
 The Municipality of Gjakovë - Opština Djakovica
 Opština za lokalnu Administraciju - Opština

№ 217/21-219/55
 Date 07.06.2019
 Gjakovë - Djakovica - Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
 OPŠTINA DJAKOVËS - OPŠTINA DJAKOVICA - MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministrište Lokalne Samosprave / Administration
 Ministry of Local Government Administration

Data / Datum / Date 07.06.2019

Prokuror i Gjeneral	Shërbetor	Shërbetor	Shërbetor
-Ul-	0-	668	

RREGULLORE
E
PUNËS SË KUVENDIT

Gjakovë, 2019



REPUBLIKA E KOSOVES/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVES
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2019

Dt. 03.06.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës duke u bazuar në nenin 122 shkronjatb, si dhe nenin 40 të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në nenin 18 shkronja 1e të Statutit të Komunës së Gjakovës, në Mbledhjen e mbajtur me dt. 03.06.2019 pas diskutimit hdhur me pikën e 3 të rendit të ditës : Miratimi i Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal, e miratohet kështu:

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Në këtë Rregullore përcaktohet mënyra, kuorumi, pjesëmarrja e publikut, rregullat e debatit, votimi, udhëheqja dhe funksionimi i punës së kuvendit, të komiteteve dhe të trupave tjera punuese të themeluna nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.

II. PËRKUTIZIMET

Neni 2

- "Ligj", nënkupton Ligjin për vetëqeverisjen lokale (L VI nr. 03/L - 040).
- "Statut", nënkupton aktin më të lartë juridik të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës.
- "Kuvendi i komunës" nënkupton organi më i lartë i komunës së Gjakovës që përbëhet nga anëtarët e zgjedhur.

- v) "Komite" nënkupton komitetet e përbërshme, komitetet konsultative dhe komitetet tjera të themeluar nga Kuvendi i Komunës në pajtim me Ligji, Statutin e Komunës dhe Rregulloren;
- vi) "Komision" nënkupton komisionet apo trupat tjera punuese të përbërshme apo përbërëse të themeluara sipas nevojës nga Kuvendi i Komunës në përputhje me Statutin;
- vii) "Anëtarë të Kuvendit" nënkupton anëtarin e Kuvendit, të zgjedhur drejtpërdrejt nga vota qytetarit, në pajtim me ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale;
- viii) "Kryetar i Komunës", nënkupton kryetarin e zgjedhur drejtpërdrejt nga votuesit që kanë të drejtë vote në komunë, në përputhje me ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale;
- ix) "Kryesues i Kuvendit", nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e Kuvendit të Komunës në Çarkovës;
- x) "Grupi i anëtarëve" nënkupton me grup që përbëhet prej së paku dy (2) anëtarëve të Kuvendit që udhëhiqet nga Shefi i grupit i cili emëruar nga vet anëtarët e atij grupi kuvendar;
- xi) "Kryesuesi i Komitetit", nënkupton kryesuesin e zgjedhur nga anëtarët e komitetit;
- xii) "Të drejtë" nënkupton person zyrtar, i emëruar politik nga Kryetari i Komunës që udhëheq me detyrë të caktuar përgjatë mandatit të njëjti me kryetarin e Komunës.

III. MBAJTTJA E MBLLEDHJEVE TË KUVENDIT DHE TË KOMITETEVE TË TIJ

Mbledhjet dhe kuorumi

Neni 3

1. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në pajtim me Ligjin dhe Statutin e Komunës, thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Kryesuesit e komiteteve tjera apo komisioneve thërretin dhe kryesojnë mbledhjet e komiteteve apo komisioneve përkatëse;
3. Kryesuesi mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës sipas LVI;
4. Kryesuesi i komiteta apo komisionit mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme të komitetit apo komisionit, me së paku 1/3 anëtarëve;
5. Në mungesë të kryesuesit, mbledhjen e udhëheq anëtari më i moshuar i Kuvendit, i pranishëm në mbledhje;
6. Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij duhet t'i trajtojë vetëm çështjet të cilat janë në kompetencën e Komunës;
7. Kuvendi i komunës dhe KPF duhet t'i mbajë së paku dhjetë mbledhje të rregullta brenda vitit kalendarik, pesë (5) të obliguara në gjatë të (6) muajve të parë dhe pesë (5) në gjatë të (6) muajve të dytë;
8. Mbledhjet e Kuvendit të komunës dhe të KPF-së caktohen në bazë të planit të punës së Kuvendit;
9. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të KPF-së thërren së paku shtatë (7) ditë para çdo mbledhje siç është e paraparë me LVI;

Neni 4

Etetat dhe njoftimet për mbledhjet e kuvendit/komiteteve

1. Anëtarët e kuvendit duhet të njoftohen për datën, vendin e mbajtjes, rendin e ditës, kohën dhe me materialin e mbledhjes.
2. Kryesuesi, përmes Shërbimit Profesional për Punë të Kuvendit, përgatit njoftimin publik për mbledhjen dhe përmes zyres për informim, shpallë njoftimin me këto të dhëna: kohën, datën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës që propozohet për punën e mbledhjes.
3. Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dërgon thirrjen për pjesëmarrje dhe materialet për mbledhje shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes të gjithë anëtarëve të Kuvendit dhe të komitetit për Politikë dhe Financa në adresat zyrtare të anëtarëve të kuvendit.
4. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, përbëhet nga më tepër se gjysma e anëtarëve, përveç rasteve kur për votim nevojiten 2/3 e anëtarëve të Kuvendit. Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe propozimet e komiteteve, merren me shumicën e fteshite të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë siç parashihen me I VI.

Neni 5

Mbledhjet e jashtëzakonshme dhe solemne të Kuvendit/komiteteve

1. Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të Komunës thirret me kërkesën e kryetarit të komunës, ose me kërkesën e së paku 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës.
2. E drejta për të thirrur mbledhjen e jashtëzakonshme përftohet të drejtën për të caktuar rendin e ditës për atë mbledhje - në këtë rast, rendi i ditës nuk mund të ndryshohet.
3. Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës/komiteut thirret së paku tri (3) ditë pune me heret - dhe anëtarët janë të njoftuar me shkrim njëkohësisht.
4. Mbledhjet urgjente mund të ftohen nga kryetari përmes telefonit ose adresës elektronike brenda ditës.
5. Kuvendi i komunës mund të mbajë mbledhje solemne në rastet e shënimit të datave dhe përjetorëve të rëndësishëm të karakterit komunal dhe shtetëror.
6. Mbledhjet solemne i thërret kryesuesi i kuvendit në bashkëpunim me kryetarin e komunës.
7. Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje në lokacion tjetër brenda territorit të komunës (salle tshat, vendbanim), nëse për këtë plotësohen kushtet e punës dhe janë në pajtueshmëri paraprakisht me kryesuesin e kuvendit dhe kryetarin e komunës.

Neni 6

Pjesëmarrja në mbledhjen e kuvendit

1. Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit duhet të siguroj kushte të nevojshme për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e kuvendit duhet të pajisen me adresë elektronike, të cilat duhet të përdoren për komunikim zyrtar. Adresat elektronike zyrtare duhet të publikohen në faqen zyrtare të komunës.

3. Anëtarët e kuvendit pajisen me kartë të identifikimit. Pajisja me kartë të identifikimit bëhet nga kompetent i administratës së komunës.
4. Kuvendi i Komunës, përkatësisht administrata komunale do t'ua lehtësoj pjesëmarrjen e anëtarëve të kuvendit me aftësi të kufizuara dhe siguroj çfarëdo ndihme teknike për këtë qëllim.
5. Secili anëtar i kuvendit është i obliguar të marrë pjesë në mbledhje të kuvendit. Secili anëtar që merr pjesë në mbledhje duhet të shënoje emrin e tij sag në librin e pjesëmarrësve ose në listën për personat e pranishëm, të parapara për këtë qëllim.
6. Në rast të pamundësisë së ardhjes në mbledhje, anëtar i kuvendit obligohet që parvomësi të njoftoj kryesuesin e kuvendit. Çdo mungesë (me ose pa arsye) në mbledhje duhet të shënohet në procesverbal.

Neni 7

Uljë në sallë e anëtarëve të kuvendit

1. Ndarrja e ulësve për anëtarët e kuvendit rregullohet në fillim të mandatit. Subjekti politik që ka më së shumti anëtar në kuvendin komunal merr ulëset e para dhe sipas renditjes.
2. Kryesuesi i kuvendit dhe kryetari i komunës ulen përballë anëtarëve të kuvendit. Nën kryetarin dhe drejtorët e drejtorive komunale ulen në ulëset e dedikuara si vende të veçanta për të njëjtin.
3. Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit ulen në një vend të përshtatshëm, përball anëtarëve të kuvendit – afër kryesuesit të kuvendit, ku mund të shohet dhe vëzhgoh procesin e punës pa pengesë.

Neni 8

Pjesëmarrja e publikut në mbledhjet e kuvendit komitetëve

1. Mbledhjet e kuvendit dhe komitetëve janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur kuvendi komiteti me votën e shumicës merr vendim për përjashtimin e publikut dhe medive nga mbledhja siç parashihet me LVL-në, neni 45.3 dhe Statutin e komunës, neni 24.
2. Pjesëtarët e publikut (qytetarët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, media, etj.) shfrytëzojnë të drejtën të ulen në vendet e dedikuara për publikun.
3. Pjesëtarët e publikut mund ta marrin fjalën në mbledhje të kuvendit komitetëve për çështje specifike, me kusht që para fillimit të mbledhjes duhet të njoftohet kryesuesi i kuvendit komiteti dhe të marrë pëlqimin nga kryesuesi. Kryesuesi i mbledhjes duhet të vendosë për rendin me të cilin personat mund t'i drejtohen pjesëmarrësve në mbledhje dhe duhet t'i ndërprisë ata, nëse diskutimi i tyre është i gjatë dhe në të përsëriten gjërat, i japin e tyre mund të zgjasë deri në 5 minuta.

Neni 9

Rendi i ditës dhe renditja e punëve

1. Rendi i ditës së mbledhjes propozohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

2. Kryetari i Komunitës dhe anëtarët e Kuvendit mund të propozojnë që një apo më shumë pikë të shtohen apo t'i hiqen rendit të ditës ose të ndryshohet renditja.
3. Kryesuesi i mbledhjes lidhur në votim çdo propozim të paraqitur për futjen ose heqjen e pikës në rend të ditës për atë mbledhje.
4. Rendi i punës në mbledhje deri në miratimin e rendit të ditës vijon me veprimet e kryesuesit dhe Shërbimit Profesional për Punë të Kuvendit:
 - a. Konstatimi i kërimit;
 - b. Arsyeimi për mospjesëmarrje të anëtarëve të kuvendit në mbledhje;
 - c. Prezantimi i pjesëmarrësve tjerë në mbledhje - pjesëmarrjen e publikut.
5. Rendi i ditës për miratim duhet të përmbajë:
 - a. miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së fundit;
 - b. pyetjet për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit;
 - c. peticionet nënshkrimet;
 - d. punët që kryhen në mbledhje, të cilat parashihen me ligj, Statutin e Komunitës;
 - e. çfarëdo çështje e shtuar nga kryesuesi i mbledhjes dhe temat që shtrohen aty;
 - f. çilado punë e papërfunduar në takimin e fundit;
 - g. raportet dhe rekomandimet e marra nga komitetet, dhe të gjitha çështjet e tjera që lindin si rezultat i raporteve;
 - h. raportet dhe rekomandimet e marra nga Drejtoret dhe çështje të tjera që dalin si rezultat i raporteve;
 - i. çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet të Komunitës dhe të shtuara nga anëtarët sipas rendit, ashtu si janë pranuar ato - propozimet e shtuara nga anëtarët, sipas radhës së pranimit të tyre.

Pyetjet për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit zgjasin deri në dy (2) minuta.

6. Pikat e rendit të ditës nuk mund të shtohen e as të ndryshohen pas miratimit të rendit të ditës nga anëtarët e kuvendit.
7. Kur një pikë e Rendit të Ditës hidhet poshtë me shumicë votash (kundër), atëherë njëta pikë çështje nuk mund të silllet për votim në kuvend në tri (3) mbledhjet e rregullta të radhës të Kuvendit. Përjashtim në rastet kur pika e propozuar ka pësuar ndryshime.

Neni 10

Rregulla e debatit

1. Anëtarët e kuvendit mund të diskutojnë për pikat e rendit të ditës në bazë të renditjes së paraqitur për diskutim. Anëtarët e kuvendit kanë të drejtë vetëm një herë të diskutojnë për pikën që është në shqyrtim. Fjala e tyre duhet të degjohet deri në përfundim dhe nuk lejohet ndërhyrja gjatë diskutimeve. Vendimi i kryesuesit për renditje e diskutimeve ose shpjegimeve nga folësit, është vendimtar.

2. Diskutimet e anëtarëve të kuvendit mund të zgjasin dhjetë (10) minuta, me përjashtim të referencës së materialeve.
3. Askush nuk ka të drejtë të diskutojë më tepër se njëherë për të njëjten pikë, me përjashtim të sqarimeve plotësuese nëse kërkohet apo lejohet nga kryesuesi i kuvendit, në kohëzgjatje deri në një (1) minutë.
4. Replika zgjat deri në tre (3) minuta - në replikë ka të drejtë vetëm njëherë personi të cilit i përmendet emri në diskutim.
5. Nëse dy ose më shumë anëtarë të kuvendit dëshirojnë të marrin fjalën, kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e diskutimit. Anëtarët i drejtohen kryesuesit të mbledhjes dhe gjatë diskutimit të tyre duhet t'u përmbahen çështjeve të diskutuara në mbledhje. Kryetarëve të grupeve kuvendare u rrehet përparësi gjatë diskutimit. Në rastin kur i jepet fjala anëtarit të flasë, atyho obligohet të dalë në tohorën e sallës, eventualisht nga vendi në rastet kur sallja e kuvendit është e pajisur me pajisjet e komunikimit (mikrofonat) para ulësve të anëtarëve të kuvendit.
6. Kryesuesi në mbledhje nuk lejon asnjë mprozim, derisa të gjithë ata që dëshirojnë të diskutojnë ta kenë bërë këtë për kohë të përcaktuar me këtë rregullorë.
7. Nëse ndonjë anëtar e kërkon sqarime, atyho ka të drejtë të marrë përgjigjen menjëherë, para se propozimi t'i nënshtrohet votimit ose me shkrim brenda afatit të paraparë me ligj.
8. Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet dhënia e propozimeve të tjera, përveç:
 - a. ndryshimeve;
 - b. propozimit të dhënë për të parandaluar çrregullimet;
 - c. propozimit për të përjashtuar publikun;
 - d. propozimit për të kaluar në pikën me radhë të rendit të ditës;
 - e. propozimit i cili kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;
 - f. propozimit për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e radhës;
 - g. propozimit për ndërprerjen e mbledhjes.
9. Gjatë kohëzgjatjes së mbledhjes, kryesuesi duhet të respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës me të drejtë diskutimi, të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje.
10. Diskutimet prej vendit dhe pa lejen e kryesuesit nuk lejohen dhe nuk përfshihen në procesverbal.
11. Nëse anëtarët e kuvendit paraqesin kërkesë për pushim të shkurtër apo ndërprerje të seancës, për këtë vendos kryesuesi i kuvendit me pajtueshmërinë e shumicës së anëtarëve të kuvendit.

Neni 11

Votimi

1. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit/Komiteteve vendimet merren përmes votimit në këto mënyra:
 - a. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës, ose përmes mënyrës që preferon anëtarja/e e Kuvendit me afërsi të kufizuara;
 - b. Votimi i fshehtë bëhet me thirrjen e secilit anëtar/e të Kuvendit për hedhjen e votës në vendin e caktuar për votim;
 - c. Votimi i regjistruar përfshin votimin e regjistruar elektronik.
2. Para votimit, secili anëtar ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen, ku do të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar.
3. Para çdo votimi duhet të konstatohet kështu për mbledhje:
4. Kur ka nevojë të bëhet votimi i propozimit për zgjedhjen e ndonjë anëtarje për pozitën e cila duhet të mbulohet nga Kështjua, dhe kur ekzistojnë dy ose më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve paraqiten në mbledhje sipas rradhës alfabetike të mbledhjes të tyre.
5. Secili anëtar mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënojë se si ai/ajo ka votuar për çështjen e caktuar, ose nëse ai/ajo ka abstenuar.
6. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komiteteve, secili anëtar ka nga një votë kryesuese ka votë shtesë, në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.
7. Vendimet e Kuvendit të Komiteteve, merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligj, Statut dhe Rregulloren e punës.
8. Në rast të votimit të fshehtë, për rastet që janë të përcaktuara me LVL dhe Statut, Sherbimi Profesional për Punë të Kuvendit duhet të sigurojë fletëvotimet (të gjithë anëtarëve me të drejtë vote sipas rradhës alfabetike bazuar në mbledhjet e tyre) dhe të sigurojë kutinë për votim.
9. Me shumicën e votave të anëtarëve prezent, do të formohet komisioni për mbështetjen e procesit të votimit – në përbërje prej tre (3) deri në pesë (5) anëtarëve.
10. Votimi bëhet menjëherë duke shënuar në fletën e votimit shenjat "X" ose "√" afër emrit të kandidatit/ës ose duke e shënuar emrin e kandidatit për të cilin anëtarja/dëshiron të votojë, pastaj e hedh fletëvotimin e tij/saj në kutinë e votimit.
11. Komisioni për mbështetjen e procesit të votimit i numëron publikisht votat në mbledhje menjëherë pas mbylljes së votimit dhe ia prezanton kryesuesit/ës të mbledhjes, ndërsa kështjua të fundit deklaron publikisht rezultatet e votimit.
Sherbimi Profesional për Punë të Kuvendit duhet t'i mbajë fletëvotimet në vend të sigurtë për se paku dymbëdhjetë muaj.

Neni 12 Procesverbali

1. Për të gjitha mbledhjet e kuvendit/komiteteve mbahet procesverbali. Procesverbali mbahet zyrtarisht nga Sherbimi Profesional për Punë të Kuvendit.
2. Në procesverbal shënohet data, koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes, pjesëmarrja e anëtarëve të pranishëm dhe të anëtarëve të ftuar, mungesat e anëtarëve të kuvendit në atë mbledhje, qeshiflet të cilat do të diskutohen - rendin e ditës, propozimet e miratuara apo të refuzuara, thelbi i diskutimeve të anëtarëve të kuvendit, rezultatin numerik të votimit dhe titullin e plotë të vendimit. Nëse kërkohet të thirret emri i secilit anëtar, në procesverbal duhet shënuar si ka votuar secili.
3. Procesverbali duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Përfashtëmërisht në raste të pengesave objektive, procesverbali mund të miratohet në mbledhjen tjetër me radhe.
4. Çdo të interesuar ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje, me përjashtim të rasteve kur procesverbali ka të bëjë me dispozitat e nenit 45.3 të LVI-së.
5. Kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi ia duhet ta nënshkruajë procesverbalin pas miratimit të tij.
6. Procesverbali original arkivohet, ndërsa kopja (e skanuar) publikohet në faqen zyrtare të komunës sipas dispozitave ligjore mbi transparencën e qeverisjes lokale.

Neni 13 Rregullat e mirësjelljes

1. Nëse gjatë procesit të punës në mbledhje të kuvendit, kryesuesi/sja i/e mbledhjes konsideron se ndonjëri prej anëtarëve të Kuvendit, drejtoritë e drejtorëve apo ndonjë zyrtarë komuna është duke penguar me dashje ose duke u sjell në mënyrë ofenduese, atij/saj duhet t'i tërhiqet vërejtja. Nëse sjelljet e anëtarit në fjalë vazhdojnë të jenë të pandryshueshme, kryesuesi i mbledhjes pas konsultave me Shetën e Grupëve Kuvendare mund të ndërmarrë njërin prej këtyre masave, veçmas ose si varg masash:
 - a. ta propozon të pranishmëve në mbledhje që anëtari të mos dëgjohet, në të cilin rast propozimi duhet të bëhet menjëherë në mbledhje, pa nevojë për krahejje, anëtari es i ndalohe diskutim i mëtejshëm në mbledhje;
 - b. e ndërhizon anëtarin e Kuvendit komitetit, të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime;
 - c. jep ndihmë që anëtari të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime;
 - d. e shtyn mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, datën dhe vendin e cilit mund të caktohet me xomë.

Nëse pjesetari i publikut me dashje ndërpret punën e mbledhjes kryesuese i mbledhjes la tërhiqet vërejtjen e tyre. Nëse anëtarët vazhdojnë të pengojnë mbledhjen kryesuese i mbledhjes e ndërzojnë pjesetarin e publikut të tërhiqet nga mbledhja.

Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim kryesuesi i mbledhjes mund të ordhënojë që të gjithë të lirojnë sallën e mbledhjes dhe mund ta shtyjë mbledhjen për një orë ose deri në kohën, datën dhe vendin i cili mund të caktohet më vonë, në koordinim me shefat e grupeve kuvendare.

4. Mbledhja e kuvendit ndërpritet vetëm në këto raste:

- a. Kur gjatë mbledhjes mungon i anëtarëve të kuvendit bie nën numrin e paraprirë për mbajtjen e mbledhjes dhe marrje të vendimeve - nëse në sallë nuk ka kuorum.
- b. Kur për shkak të qëndrimit të gjatë në mbledhje dhe lodhjes së anëtarëve të kuvendit, mbledhja ndërpritet dhe e njëjta vazhdohet më të njëjtin rend dite brenda javës, në ditën që caktohet nga kryesuesi i kuvendit.
- c. Në rastet e jashtëzakonshme.

Neni 14

Përdorimi i gjuhëve dhe shenjave të komunikimit në mbledhjet e kuvendit/komiteteve

1. Mbledhjet e kuvendit/komiteteve mbahen në gjuhët zyrtare të komunes të përcaktuara me dispozitat ligjore.
2. Me kërkesë të anëtarit/es të kuvendit me aftësi të kufizuara, për mënyrën me të cilën komunikim anëtarja, duhet të sigurohet komunikimi përmes gjuhës së shenjave ose interpretit ma anë të cilës pëmbushen të drejtat themelore të atij/saj anëtarit/e.

Neni 15

Komiteti për Politikë e Financa (KPF)

1. Pikat e propozuara për rend të ditës të cilat ndërlidhen me buxhetin komunal dhe program komunal duhet që në mënyrë patjetër së pari të diskutohen në KPF dhe pastaj të futen në rend dite për kuvendin komunal.
2. Në raste të rralha, urgjente dhe me rëndësi të veçantë mund të bëhet përjashtim.
3. Dëgjimet buxhetore organizohen nga KPF. Në këto dëgjime, sipas nevojës, mund të flahen edhe drejtorët përkatës. Kalendarit i takimeve me qytetarët hartohet nga KPF.
4. Anëtarit i Kuvendit Komunal mund t'i drejtohet të pranishmëve në vitindë komisioni të kuvendit të komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Ai apo ajo mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është me interes të përgjithshëm (sipas nenit 39.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale).
5. Anëtarët e Kuvendit të Komunes të cilët nuk arrijnë të krijojnë Grupin e Anëtarëve nuk mund të kenë akses në Komitete apo Komision. Përjashtim bëjnë rasti kur një Grup Kuvendarë qytetër e propozon si përfaqësues të tyre.

Neni 16

Konflikti i interesit

1. Anëtarja të Kuvendit apo anëtarja të Komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilën do detyrë të të cilën ai apo ajo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ka interes personal apo material.
2. Çdo anëtar e të Kuvendit duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesave që mund të ndodhë në një mbledhjeve të të cilën është i pranishëm. Çdo anëtar e të Kuvendit mund të ofrojë informacione që janë në interes të anëtaritës jetësh.
3. Çdo anëtar e të Kuvendit mund të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, nëse konsideron se ato mund të çojnë gjer të konflikti i interesave.
4. Anëtar e të afërt i e familjes llogariten anëtarët e familjes sic e përkufizon Ligji (Punes Nr. 031-210).

IV. PROCEDURA E NDRYSHIMIT

Neni 17

1. Procedura e ndryshimit të Rregullores së punës duhet të jetë si vijon:
 - a. Ndryshimin e kësaj rregulloreje mund ta kërkojë çdo anëtar e të Kuvendit;
 - b. Propozimi për ndryshim duhet t'i paraqitet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shtuqizohet Rregulloria për punën e Kuvendit të Komunës të datës 06.03.2009;
2. Ky vendim hyi në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Gjpkove,

Qershor 2019.

